



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Ante-Group” shpk

Adresa: Lagjia “Barrikada”, Zona Kadastrale Nr. 8501, Godina me Nr. Pasurie 3/423ND, Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar” “Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”, Loti I: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Shërbimi i Pastrimit të Tiranës”, Loti I: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana I”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: Ref-80604-12-01-2020

Fondi limit në total: 2,787,613,252 (dy miliard e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Fondi limit Loti I: 559,686,066 (pesëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.

Kohëzgjatja e kontratës: Afati maksimal i realizimit të shërbimit do të jetë 3-vjecar. Operatorët ekonomik të shpallur fitues (per secilin Lot) do të rinovojnë kontratat objekt të kësaj Marrëveshje Kuadër çdo 1 (një) vit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 25.01.2021, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 115 datë 07.12.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk

NUIS K71401004W

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë.

2. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk

NUIS K91413010N

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë.

3. Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk

NUIS J62904100D

Vlera e ofertës = **553,701,525** (pesëqind e pesëdhjetë e tre milion e shtatëqind e një mijë e pesëqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

**Janë s’kualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk

NUIS K71401004W

- Operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm Vërtetimin e Debisë me Nr10326/1 Prot. datë 17.11.2020.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk

NUIS K91413010N

- Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik vetëm Ekstraktin e Regjistrisë Tregtar.

Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Ante-Group” shpk**, me adresë: *Lagjia “Barrikada”, Zona Kadastrale Nr. 8501, Godina me Nr. Pasurie 3/423ND, Tiranë*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **553,701,525**

(pesëqind e pesëdhjetë e tre milion e shtatëqind e një mijë e pesëqind e njëzetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 03.02.2021

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.